

RELACION SHPJEGUES

PËR PROJEKT VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR MIRATIMIN E AGJENDËS KOMBËTARE PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE 2027-2030

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektakti propozohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS) në cilësinë e institucionit përgjegjës, për hartimin dhe koordinimin e politikave në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, si një dokument strategjik ndërsektorial i Qeverisë shqiptare.

Qëllimi i Agjendës Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2027–2030 (AKDF) është të sigurojë një kuadër strategjik kombëtar, ndërsektorial dhe të orientuar drejt rezultateve, për promovimin, mbrojtjen dhe garantimin efektiv të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, në përputhje me Ligjin nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2023), standardet e Bashkimit Evropian dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Dokumenti strategjik ka natyrë ndërsektoriale dhe synon forcimin e një sistemi të integruar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, duke garantuar akses të barabartë në shërbime cilësore, mbrojtje efektive nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi dhe neglizhimi, si dhe mundësi të barabarta për zhvillim, mirëqenie dhe pjesëmarrje për çdo fëmijë në Shqipëri.

Vizioni i AKDF është që çdo fëmijë në Shqipëri gëzon të drejta të plota dhe të barabarta, rritet në një mjedis të sigurt, mbrojtës dhe gjithëpërfshirës, ka akses në shërbime cilësore dhe të integruara, mbrohet nga çdo formë dhune, abuzimi, shfrytëzimi, diskriminimi dhe përjashtimi social, si dhe fuqizohet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në jetën familjare, komunitare dhe shoqërore, duke realizuar potencialin e tij të plotë në një shoqëri demokratike, të drejtë, të qëndrueshme dhe të harmonizuar me standardet evropiane të të drejtave të fëmijëve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE

AKDF 2027-2030 harmonizohet dhe ndërvepron me dokumentet strategjike kombëtare, ndër të cilat janë: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030; Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030; Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i Veprimit 2022–2029; Dokumenti i Politikave për Përfshirjen Sociale 2024–2028 në Republikën e Shqipërisë; Strategjia Ndërsektoriale për Drejtësinë për të Mitur 2022–2026, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve 2022–2026; Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024–2030 dhe Plani i Veprimit 2024–2026; Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030; Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030; Strategjia

Kombëtare e Arsimit 2021–2026; Plani i Veprimit i Agjendës Digjitale për Arsimin 2025–2030 dhe standardet për arritjen e kompetencave digjitale, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 03.12.2025; Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave dhe procesi për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2026–2030; Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025–2030; Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025; Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2021–2025, Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2024); dhe Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030.

Projektakti është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të akteve të MSHMS, për 4-mujorin e dytë të vitit 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Fëmijët në Shqipëri dhe në të gjithë botën duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të jenë në gjendje të jetojnë të sigurtë, duke qenë të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës.

Në vitin 2025, Shqipëria avancoi ndjeshëm procesin e integritit evropian duke hapur të gjashtë grup-kapitujt e negociatave me Bashkimin Evropian. Në këtë kontekst, çështjet e të drejtave të fëmijëve, përfshirjes sociale, arsimit, mbrojtjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor fituan një rëndësi më të madhe në dialogun politik të lidhur me procesin e anëtarësimit në BE.

Sipas UNICEF, Shqipëria renditet e 45-ta nga 167 vende në Indeksin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG Index) për vitin 2025, duke reflektuar progres në qeverisje dhe reforma institucionale, por duke vijuar të përballlet me sfida të rëndësishme që lidhen me varfërinë e fëmijëve, pabarazitë dhe aksesin e pabarabartë në shërbime, veçanërisht për fëmijët në zonat rurale, familjet e mëdha dhe komunitetet e marginalizuara.

Raportet e UNICEF Shqipëri dhe Raporti i Progresit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë e vërtetojnë se, megjithëse Shqipëria ka bërë progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional për të drejtat e fëmijëve, mbeten sfida të konsiderueshme në garantimin e aksesit të barabartë në shërbime cilësore dhe në reduktimin e pabarazive sociale dhe territoriale.

Nga analiza e UNICEF mbi kapitalin njerëzor rezulton se fëmijët e lindur sot në Shqipëri pritet të arrijnë vetëm 63% të potencialit të tyre produktiv në moshë madhore, nën mesataren rajonale prej 69%, duke treguar nevojën për investime më të forta në zhvillimin e hershëm, arsim cilësor, mbrojtje sociale dhe mirëqenie të fëmijëve dhe të rinjve.

Raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026 e vërteton progres të rëndësishëm në forcimin e kuadrit institucional, ligjor dhe programor për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, megjithëse mbeten ende sfida të

rëndësishme në drejtim të zbatimit të plotë, koordinimit ndërsektorial dhe garantimit të aksesit të barabartë në shërbime cilësore për çdo fëmijë.

Gjatë periudhës 2021–2025 janë raportuar 170 nga 185 aktivitetet e planifikuara në Agjendë (92%), ku 64% e aktiviteteve rezultojnë plotësisht të realizuara, 27% pjesërisht të realizuara dhe 9% të parealizuara. Nga 20 tregues strategjikë të rezultateve, institucionet kanë raportuar për 17 prej tyre, ku 77% konsiderohen plotësisht të realizuar dhe 18% pjesërisht të realizuar.

Dokumenti synon të forcojë koherencën ndërmjet reformave sektoriale dhe prioriteteve kombëtare për fëmijët, të mbështesë zhvillimin e një sistemi të integruar të mbrojtjes dhe mirëqenies së fëmijëve dhe të sigurojë një qasje të koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në adresimin e nevojave të tyre.

Miratimi i këtij dokumenti, synon të konsolidojë dhe forcojë sistemin kombëtar të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve përmes:

- Garantimit të vazhdimësisë dhe përfundimit të reformave të nisura në kuadër të Agjendës 2021–2026;
- Adresimit të boshllëqeve sistematike dhe rreziqeve të reja që prekin fëmijët;
- Forcimit të koordinimit ndërinstitutional, llogaridhënies dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në nivel qendror dhe vendor;
- Harmonizimit të politikave kombëtare për të drejtat e fëmijëve me prioritetet, standardet dhe iniciativat e Bashkimit Evropian; dhe
- Forcimit të koherencës me strategjitë sektoriale dhe proceset kombëtare në fushën e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor.

Gjithashtu mundëson reflektimin në mënyrë të strukturuar dhe të matshme, të masave për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 2023, si edhe forcimin më tej për përafrimin me standardet evropiane, në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian.

IV.VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti propozohet në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të Ligjit Nr.18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

V.VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Dokumenti strategjik parashikon politikat për fëmijët dhe është në harmoni me:

- Vërejtjet Përfundimtare të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës për Shqipërinë (2023);

- Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs) të lidhura me fëmijët dhe mirëqenien e tyre;
- Politikat dhe iniciativat e Bashkimit Evropian, përfshirë Strategjinë e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve, Garancinë Evropiane për Fëmijët dhe iniciativa të tjera relevante të BE-së;
- Strategjia e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijëve;
- Garancia Evropiane për Fëmijët (European Child Guarantee);
- Raporti i Progresit të BE-së për Shqipërinë 2025;
- Rekomandimi i Komisionit Evropian, datë 23.04.2024, për zhvillimin dhe forcimin e sistemeve të integruara të mbrojtjes së fëmijëve në interesin më të lartë të fëmijës;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 13 (2011) i Komitetit për të Drejtat e Fëmijës mbi të drejtën e fëmijës për të qenë i lirë nga të gjitha format e dhunës;
- Strategjia e BE-së për të Drejtat e Viktimave 2020–2025;
- Kuadri i ri strategjik i BE-së për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e komuniteteve rome;
- Komenti i Përgjithshëm nr. 12 (2009), “Mbi të drejtën e fëmijës për t’u dëgjuar”;
- Rekomandimi CM/Rec(2012)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve nën moshën 18 vjeç; dhe
- Rekomandimi i Këshillit të Evropës i datës 8 dhjetor 2022, “Mbi edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme”: Objektivat e Barcelonës për vitin 2030.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Agjenda Kombëtare për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve 2027–2030 strukturohet mbi tre qëllime strategjike kryesore:

1. Forcimin e qeverisjes qendrore, vendore dhe ndërsektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve;
2. Eliminimin e të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktikave të dëmshme ndaj fëmijëve, përmes parandalimit, mbrojtjes efektive, drejtësisë miqësore dhe shërbimeve të integruara; si dhe
3. Promovimin e mirëqenies, zhvillimit gjithëpërfshirës dhe mundësive të barabarta për çdo fëmijë, përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, mbrojtje sociale, transformim digjital dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Agjenda Kombëtare e Fëmijëve përfaqëson në të gjitha kuptimet e saj një strategji ndërsektoriale. Përfituesit e veprimeve janë fëmijët dhe kjo përfshin çdo fushë të mundshme veprimi sektorial. Për më tepër, një nga synimet kryesore të strategjisë lidhet me koordinimin dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale për të adresuar çështjet e fëmijëve.

Qëllimi strategjik I: Forcimi i qeverisjes qendrore dhe vendore dhe ndër-sektoriale për garantimin e një sistemi të integruar, të financuar dhe të monitoruar në mënyrë efektive për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijëve

Objektivi specifik I.1: Institucione dhe mekanizma të fuqizuar në nivel qendror dhe vendor për koordinimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive të politikave për fëmijët

Objektivi specifik II.1: Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve në familje, shkollë, komunitet dhe në mjedisin digjital përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe mbështetjes së prindërimit pozitiv.

Qëllimi strategjik II: Eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit, neglizhimit dhe praktikave të dëmshme ndaj fëmijëve

Objektivi specifik II.2: Përmirësimi i kuadrit normativ si dhe forcimi i mekanizmave për raportimin, identifikimin dhe reagimin e shpejtë ndaj rasteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve (të fëmijëve në nevojë për mbrojtje).

Objektivi specifik II.3: Sigurimi i shërbimeve të integruara, të aksesueshme dhe cilësore për mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve viktime të dhunës, trafikimit, shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual dhe abuzimin dhe shfrytëzimin online (të fëmijëve në nevojë për mbrojtje).

Objektivi specifik II.4: Forcimi i drejtësisë miqësore për fëmijët dhe mbrojtja efektive e fëmijëve viktime, dëshmitarë ose në konflikt me ligjin nga riviktimizimi dhe trauma sekondare.

Qëllimi strategjik III: Mirëqenie, zhvillim gjithëpërfshirës dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë përmes aksesit të barabartë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore dhe sociale, dhe përfshirje aktive në jetën shoqërore dhe ekonomike

Objektivi specifik III.1: Reduktimi i varfërisë së fëmijëve dhe forcimi i mbështetjes për familjet në situata vulnerabël

Objektivi specifik III.2: Sigurimi i aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës

Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në shërbime cilësore shëndetësore dhe mirëqenie psikologjike

Objektivi specifik III.4: Transformimi digjital dhe përdorimi etik i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në funksion të të drejtave të fëmijëve dhe mirëqenies së tyre

Zbatimi i AKDF 2027-2030 do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për procesin e mbledhjes së të dhënave, në kuadrin e monitorimit dhe raportimit të progresit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij projektakti ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencia Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), INSTAT-i, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Policia e Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave

Personale, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Autoriteti i Mediave Audiovizive, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË DO TË KONTRIBOJNË NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar dhe koordinuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me kontributin e grupit ndërinstytucional të punës, krijuar me Urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nr. 547, datë 05.11.2025, “Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për hartimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027–2030”, si dhe me mbështetjen e UNICEF, përmes një grupi ekspertësh, të cilët lehtësuan punën e GNP, në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri tek kostimi dhe përgatitja e pasaportës së treguesve. Kontribute kanë dhënë gjatë procesit të konsultimit dhe aktorë të tjerë nga institucione të pavaruara, si edhe organizatat e shoqërisë civile, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

- Më 22 dhjetor 2025, u zhvillua takimi i parë i grupit ndërinstytucional të punës në të cilin u prezantua edhe raporti i monitorimit të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve për vitet 2021-2025.
- Në kuadër të procesit për hartimin e dokumentit strategjik, në datën 20 prill 2026 dhe në datën 26 maj 2026, janë zhvilluar dy takime me përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke dhënë sugjerime dhe komente lidhur me përmbajtjen e këtij draft dokumenti.
- Në datën 27 prill 2026 u realizua takimi i dytë, online, i grupit ndërinstytucional të punës ku u prezantua draft dokumenti paraprak, me qëllimet, parimet kryesore, objektivat dhe masat që përmban Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajit maj 2026, ka zhvilluar takime konsultative me përfaqësues të grupit ndërinstytucional të punës, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të institucioneve respektive lidhur me përcaktimin e indikatorëve, bazuar në objektivat dhe masat që përmban ky draft dokument.

- Fëmijët ishin pjesë e rëndësishme e procesit për hartimin e këtij dokumenti me pjesëmarrjen e tyre në takimet e zhvilluara në periudhën 21-26 maj 2026. Procesi u inicua nga MSHMS, në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, me mbështetjen e UNICEF dhe organizata të shoqërisë civile. Takimet kishin për qëllim për të dëgjuar dhe mbledhur pikëpamjet e fëmijëve lidhur me draft dokumentin.

Në total, u zhvilluan 5 takime me grupe të fokusuara, me pjesëmarrjen e 74 fëmijëve të grupmohës nga 12-18 vjeç, nga 4 zona të Shqipërisë (Tiranë, Vorë, Kukës dhe Cërrik), në shkolla dhe qendra multifunksionale, ku ata përfitojnë shërbime të ndryshme, si edhe fëmijët

që janë pjesë si vëzhgues, në Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Mendimet dhe komentet e dhëna prej tyre, janë pasqyruar në masat e parashikuara në AKDF 2027-2030. Zëri i fëmijëve është gjithashtu një kapitull i veçantë në dokumentin strategjik.

Projektakti do të dërgohet për konsultim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator, Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës Shtetërore (SASPAC), INSTAT-i, Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Policinë e Shtetit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Autoritetin Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare të këtij projekti janë përlllogaritur për çdo aktivitet të AKDF 2027-2030, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar.

Kostimi i Planit është realizuar në bazë të metodologjive dhe praktikës së planifikimit buxhetor, me qëllim përcaktimin e kostove indikative mbështetur në qëllimet, masat, treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në produktet e identifikuara për secilin aktivitet.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin me Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 (faza e II), të të gjitha ministrive që kanë masa në këtë plan dhe institucionet e varësisë që janë përfshirë në zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, si dhe në kostot e strategjive të tjera të listuara në këtë dokument dhe kanë ndihmuar për hartimin e aktiviteve.

Plani i Veprimit për zbatimin e dokumentit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Gjatë procesit të kostimit janë identifikuar shpenzimet për secilin aktivitet të detajuar dhe ato janë klasifikuar sipas kategorive të paracaktuara të shpenzimeve.

Metodologjia e përdorur për kostimin dhe ndarjen e tyre bazohet në një strukturë të qartë klasifikimi, e cila parashikon ndarjen e shpenzimeve në kategoritë e mëposhtme:

- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime operative;
- Trajnime, studime, asistencë teknike, etj.;
- Investime.

Ky klasifikim mundëson një paraqitje të qartë dhe të strukturuar të kostove, duke lehtësuar analizën, planifikimin dhe monitorimin e tyre. Përlllogaritjet janë realizuar sipas viteve

financiare, duke paraqitur një shpërndarje të qartë të fondeve/për aktivitet/për objektiv/për qëllim, për secilën fushë përkatëse.

Kostoja totale për zbatimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2027-2030, është vlerësuar në një vlerë prej 1 991 999 171 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një) lekë.

Kjo kosto shpërndahet si më poshtë:

- 1 289 798 262 (një miliard e dyqind e tetëdhjetë e nëntë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, të vlerësuar kontribut nga Buxheti i Shtetit;
- 330,996,000 (treqind e tridhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të parashikuar për t'u siguruar nga donatorë/financim i huaj;
- 371,204,909 (treqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e katër mijë e nëntëqind e nëntë. lekë, hendek financiar, i cili mund të mbulohet përmes:
 - i) rishikimit dhe prioritizimit të masave brenda tavanëve të Programit Buxhetor Afatmesëm gjatë cikleve të ardhshme buxhetore;
 - ii) mobilizimit të fondeve nga instrumentet e asistencës së huaj, nëpërmjet organizatave UN,WHO, etj, përfshirë edhe programet e Bashkimit Evropian (si p.sh. IPA) dhe projekte të tjera të financuara nga partnerët zhvillimorë ndërkombëtarë. Programimi i këtyre fondeve realizohet në përputhje me ciklet shumëvjeçare të planifikimit dhe kuadrot përkatëse të bashkëpunimit (marrëveshje/memorandume mirëkuptimi), mbi bazën e prioriteteve të dakordësuara me palën shqiptare. Në këtë kontekst, angazhimet buxhetore reflektohen në mënyrë të fazuar në periudhat pasuese, duke integruar gradualisht edhe nevojat e pambuluara të identifikuara në kuadër të Agjendës;
 - iii) zgjerimit të bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare dhe donatorë bilateralë për financimin e ndërhyrjeve specifike; si dhe shfrytëzimit të skemave të bashkëfinancimit dhe mekanizmave të tjerë financiarë, aty ku është e aplikueshme.

PROPOZUESI

MINISTRI I SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Evis SALA